

TAKIMI

Kryebashkiaku Mziu pret në zyrë ekspertin e menaxhimit të ujit në kompaninë CEWAS, Johannes Heeb
 FAQE **3**



INVESTIMI

Bloku i pallateve në Babrru-Qendër merr dita-ditës pamje tjetër
 FAQE **5**



TRANSPORTI PUBLIK

Bashkia Kamëz shton një tjetër linjë të re qytetëse
 FAQE **6**



NË PALLATIN E KULTURËS

Koncert recital i nxënësës dhe këngëtares së re Eglantina Babqori
 FAQE **7**



Gazetë e Bashkisë Kamëz
KAMZA

E përdyjavshme
 Nr. 200 qershor 2017
 Çmimi 20 lekë
 drmediakamez@gmail.com
 www.kamza.gov.al

Basha: Në asnjë vend tjetër nuk është sjellë më egërsisht Edi Rama me qytetarët sesa në Kamëz

FAQE 2

Reagimi, Mziu: Edi Rama parandien humbjen e thellë në Kamëz, urdhëron policinë të bëjë kallëzim

Faqe 2

Emër i ri, investim i ri i Bashkisë Kamëz, ndërtohet rruga "Republika e Re"

Faqe 4

Drejtorja e Shërbimeve Publike monitoron tabelat e emërtimit rrugor për zëvendësimin e atyre të dëmtuara

Faqe 6

Kryebashkiaku Xhelal Mziu në emisionin "Aktualitet" në TV "Shijak" nga gazetari Bejdo Malo

Faqe 3



Investimi drejt përfundimit, kryebashkiaku Xhelal Mziu inspekton punimet në rrugën "Demokracia"

FAQE 4



NË BRENDËSI

Vijon puna për ndërtimin e rrugës "Liria" në Frutikulturë

FAQE 4

Kryebashkiaku Mziu përshëndet në ditën finale të festivalit të kopshteve "Cicërimat e Kamzës"

FAQE 6

Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit, shërbim në kohë dhe me cilësi, 50 kontejnerë të rinj në rrugët kryesore

FAQE 6

Ndërtimi i Rrugës së Zanave dhe i rrugës "Torino", një standard më i lartë për infrastrukturën e lagjes Bathore 1

FAQE 4

Kryebashkiaku Xhelal Mziu përgëzon ekipin e futbollit për shpalljen kampion i Kategorisë së Parë

FAQE 8



Lulzim Basha: Në asnjë vend tjetër të Shqipërisë nuk është sjellë më egërsisht Edi Rama me qytetarët sesa në Kamëz

Kryetari i PD, z. Lulzim Basha, gjatë një takimi që pati me qytetarët e Kamzës, ndër të tjera, u shpreh se në asnjë vend tjetër të Shqipërisë nuk është sjellë më egërsisht Edi Rama me qytetarët sesa në Kamëz. Ai theksoi se Kamza, njësoj si gjithë Shqipëria, vuan krizën e thellë ekonomike. Kjo krizë, sipas tij, është pasojë e qeverisjes së Edi Ramës, që rriti taksat, rriti çmimin e energjisë, vërsuli shtetin e korruptuar kundër qytetarëve dhe me taksat e rritura nuk bëri asgjë për njerëzit. As rrogat nuk i rriti, as pensionet nuk i rriti, as investimet që ndihmojnë ekonominë nuk i bëri.



“Kamza, njësoj si gjithë Shqipëria, vuan krizën e thellë ekonomike. Kjo krizë është pasojë e qeverisjes së Edi Ramës, që rriti taksat, rriti çmimin e energjisë, vërsuli shtetin e korruptuar kundër qytetarëve dhe me taksat e rritura nuk bëri asgjë për njerëzit. As rrogat nuk i rriti, as pensionet nuk i rriti, as investimet që ndihmojnë ekonominë nuk i bëri. Në asnjë vend tjetër të Shqipërisë nuk është sjellë më egërsisht Edi Rama me qytetarët sesa në Kamëz. Diskriminimi, urrejtja që ka treguar ndaj popullsisë së qytetit të pestë më të madh të Shqipërisë tregon se gjithë pushteti i tij për katër vite nuk ka qenë në ndihmë të qytetarëve, po kundër qytetarëve”, - u shpreh z. Basha, duke vijuar më tej: “E filloi me premtime të mëdha, me 300 mijë vende pune, me shëndetësi falas,



me legalizime falas, e mbani mend apo jo, kur firmosi këtu për legalizime falas dhe të gjitha ishin gënjeshtër, sepse asnjë prej premtimeve të tij nuk ishte i bazuar në plan. Plani i vetëm i Edi Ramës ishte pushteti, ishte pasurimi i tij dhe i një çete njerëzish, të cilëve ua dorëzoi shtetin në dorë në kurriz të mjerimit, të varfërimin të përditshëm të shqiptarëve.

Sot një javë kemi në dorë ta shembim njëherë e mirë këtë sistem të korruptuar dhe të inkriminuar. Sot një javë kemi në dorë ta shembim me votë republikën e vjetër. Unë e di që mezi po prisni shpagimin për katër vite terror, katër vite keq-qeverisje, katër vite korrupsion.

Kështu ishte me këdo që takova, sipërmarrës të vegjël, biznesi i vogël apo klientë, të gjithë mezi po presin ditën të gjykojnë me votë qeverinë më të mbrapshtë, më të korruptuar dhe më antinjerëzore, më antipopullore që ka qeverisur këto katër vite me në krye Edi Ramën.

E di edhe Edi Rama se çfarë e pret më datë 25 si sot një javë, ndaj çfarë bën? Si fëmijë i vogël është përpjekur me u futë poshtë minderit dhe me ndërru rrobat aty, me dalë me thënë: Nuk jam më Rilindja, nuk jam më Partia Socialiste. Mendon se shqiptarët do të harrojnë katër vjet të keq-qeverisjes, se ky del javën e fundit ngre dy gishtat, po dalja me dy gishta në javën e fundit nuk e bën opozitë.

Njeriu përgjegjës për varfërinë është Edi Rama, njeriu përgjegjës për taksat e larta

është Edi Rama. Njeriu përgjegjës për rritjen e faturës së energjisë dhe rritjen e çmimit të naftës e të gazit është Edi Rama. Njeriu përgjegjës për papunësinë masive në Kamëz, në Tiranë, në gjithë Shqipërinë e në veçanti të të rinjve është Edi Rama. Njeriu që rriti tarifën e universiteteve dhe la jashtë universiteteve qindra të rinj është Edi Rama. Njeriu që hoqi gjysmën e familjeve nga ndihma ekonomike dhe i ka lënë për bukën e gojës, pa drita, pa bukë, pa shpresë është Edi Rama.

Kësaj do t'i japim fund, apo jo, më 25 qershor. Më 25 qershor shqiptarët do të bashkohen këtu në Kamëz e në gjithë Shqipërinë. Do bashkohen në një bashkim të jashtëzakonshëm siç nuk është parë këto 25 vite njësoj, si në '92-shin, por me një ëndërr shumë më të madhe, shumë më të prekshme, për një republikë të re të qytetarëve të thjeshtë e të zakonshëm, me taksat të ulëta, me uljen e çmimit të energjisë, me kthimin e fashës mbrojtëse për familjet në gjendje të dobët ekonomike, me rikthimin e ndihmës ekonomike për të gjitha familjet që kanë nevojë për to e jo thjesht lëmshë, por ndihmë ekonomike plus pagesën e faturës së energjisë dhe faturës së ujit për konsum familjar, me investime në infrastrukturën e Kamzës dhe gjithë Shqipërisë, që të ndihmojnë qytetarët, jo palma që thahen vetëm për të mbushur xhepat e pushtetarëve.

Me të gjitha këto masa ne do të sigurojmë punësim, ne do të sigurojmë xhiro dhe konsum, i cili në vetvete do të tërheqë xhiron

“ Diskriminimi, urrejtja që ka treguar ndaj popullsisë së qytetit të pestë më të madh të Shqipërisë tregon se gjithë pushteti i tij për katër vite nuk ka qenë në ndihmë të qytetarëve, po kundër qytetarëve. ”

ekonomike, do fillojë punësimin në Kamëz e në gjithë Shqipërinë. Investime të mëdha, të brendshme dhe të huaja, do të vijnë në Shqipëri.

Unë e di që mezi e prisni datën 25. Shqipëria mezi po e pret ndryshimin, ndryshimin e vërtetë, jo bashkëjetesën me republikën e vjetër. Mezi po prisni që ta shembni republikën e vjetër. Edhe bota mbarë mezi po pret të shembet republika e vjetër. As Amerika, as Evropa nuk e pranojnë më kurrë regjimin e drogës, regjimin e krimit, regjimin antipopullor që shkatërroi ekonominë e vendit dhe çoi qindra mijëra shqiptarë në azil. Ndaj, mos kini asnjë dyshim. Le të luftojmë natë e ditë këtë javë, ta bëjmë bashkimin më të madh të shqiptarëve se data 25 do të jetë dita e një fitoreje të shkëlqyer, të një fitoreje të jashtëzakonshme të popullit shqiptar, e Republikës së Re, e ekonomisë së fortë, e taksave të ulëta, e rritjes së pensioneve dhe ndihmës ekonomike, e një qeverie dhe një kryeministri të qytetarëve të thjeshtë të Kamzës dhe të gjithë Shqipërisë. I tillë do të jem unë krah për krah jush dhe do të zgjidhim bashkë hallet dhe problemet e mëdha e do të shtrojmë rrugën e një rritjeje ekonomike për Kamzën e për gjithë Shqipërinë.

Zoti ju bekoftë ju! Jeni pararojë, jeni tmerri i republikës së vjetër, jeni makthi i republikës së vjetër, jeni makthi i oligarkisë. Bashkë do të çelim më datë 25, duke votuar numrin 6, derën e zhvillimit, punësimit, punës dhe mirëqenies për qytetarët e Kamzës dhe gjithë Shqipërisë.

Zoti ju bekoftë ju! Fitore!” - e mbylli fjalën e tij Lulzim Basha.

REAGIM I KRYEBASHKIAKUT XHELAL MZIU LIDHUR ME AKUZAT DHE SHPIFJET E EDI RAMËS

“Kërkoj ndjesë për keqkuptimet e krijuara me qëllim nga propaganda e Edi Ramës në lidhje me një deklaratë timen, të veçuar, të nxjerrë nga konteksti, e të interpretuar sipas oreksit politik dhe elektoral të qeverisë.



Në fjalën time në një takim me banorët e Valiasit unë u jam referuar ndërtimeve pa leje, në shkelje të hapur të ligjit, që kanë shpërthyer

gjatë kësaj fushate elektorale, dhe si mburojë kanë flamujt e PS-së dhe të LSI-së, dhe kandidatët e tyre që i nxitin këto paligjshmëri duke kërkuar votën në këmbim.

Gjatë gjithë punës sime, jam krenar që kam mbrojtur dhe kam punuar e shërbyer, që ndërtimet e njerëzve të ardhur në Kamëz e në Paskuqan nga gjithë Shqipëria, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, të legalizohen, të urbanizohen, të marrin shërbime dhe banesat e tyre të kenë vlerë.

Njeriu që shemb dhe prish, njihet fort mirë, ai është Edi Rama”.

Mziu: Edi Rama parandien humbjen e thellë në Kamëz, urdhëron policinë të bëjë kallëzim

Frika nga humbja e radhës, më dërrmuese se e paraardhësja në Kamëz, ka bërë që Policia e Shtetit të kallëzojë kryetarin e Bashkisë së Kamzës me urdhër të Kryeministrit. Kallëzimi vjen për një deklaratë rreth ndërtimeve pa

leje që po lulëzojnë nën mburojën qeveritare, deklaratë të cilën Xhelal Mziu e sqaroi publikisht për opinionin publik, duke kërkuar ndjesë për keqkuptimin dhe duke pohuar se fjala e tij ishte keqpërdorur dhe ishte interpretuar politikisht sipas oreksit elektoral të qeverisë.

I kujtojmë Edi Ramës që e parandien humbjen dhe përmes këtij urdhri politik kërkon të bëjë presion se, sikurse më tani, ndëshkimi edhe më i ashpër e pret më 25 qershor përmes votës. Kamza dhe Paskuqani do të votojnë në plebishit kundër Edi Ramës për persekutimin politik dhe krahinor që ky Kryeministër e ka shfaqur dhe u ka bërë banorëve të kësaj zone. Do të votojë kundër Edi Ramës, për papunësinë, varfërinë e ulur këmbëkryq në mjaft familje, për qindra e qindra familjarë të burgosur padrejtësisht për energjinë elektrike, mijëra të tjerë për faturat e fryra padrejtësisht si dhe për rritjen e çmimit të energjisë. Do të votohet kundër

Ramës edhe për faktin se mjaft familje janë burgosur padrejtësisht për vënien e një tulle apo një tjegulle! Vota kundër kësaj qeverie do të jetë edhe për faktin se në 4 vite, zero fonde ka akorduar për Bashkinë Kamëz, fonde që do të shkonin për projekte që do të ndikonin në përmirësimin e jetesës së qytetarëve të majtë dhe të djathtë. Në sirtarët e qeverisë flenë mbi 135 projekte të Bashkisë Kamëz në fusha të ndryshme, si: rrugë, ujësjellës, shkolla, çerdhe, kopshte, treg, rivitalizimin urban etj., por që Rama as ka denjuar të kthejë përgjigje dhe jo të akordojë fonde.

Kallëzimi ndaj Xhelal Mziut nuk ka se si të mos jetë një hakmarrje, ku Kamza nën drejtimin tij ka ndryshuar rrënjësisht me qindra kilometra rrugë të shtruara, rrjet kanalizimesh, ujësjellës, 18 objekte arsimore të ndërtuara dhe të tjera të rikonstruara, pallat kulture, objekte sportive etj. Garantojmë Ramën se më 25 qershor e pret një humbje e thellë.



Kryebashkiaku Mziu pret në zyrë ekspertin e menaxhimit të ujit në kompaninë CEWAS, Johannes Heeb

Kryetari i Bashkisë, z. Xhelal Mziu, priti në një takim ekspertin e menaxhimit të ujit në kompaninë CEWAS, Johannes Heeb.

Takimi u zhvillua pas përfundimit me sukses të workshop-it për menaxhimin e integritetit me Ndërmarrjen e Ujësllës-Kanalizimeve në kuadër të fazës së dytë të projektit të ujësllës për qytetin e Kamzës. Pasi e falënderoi kryebashkiakun Mziu për pritjen, z. Heeb u shpreh se çdo gjë gjatë workshop-it shkoi me sukses. "Sapo mbaruam workshop-in e integritetit.

Ishte shumë i mirë. Çdo gjë shkoi me sukses, grupi ishte i angazhuar. Nga ana jonë mbështetja do të jetë e plotë, që çdo gjë të shkojë përpara. Për dy ditë kemi bërë një punë të mirë për sa i përket programit, i cili do të zbatohet në 6 muaj", - u shpreh eksperti Johannes Heeb.

Ndërkaq, kryebashkiaku Mziu në fjalën e tij u shpreh se Bashkia dhe Ndërmarrja e Ujësllës-Kanalizimeve mbeten të angazhuar për të qenë të besueshëm në bashkëpunimin e mëtejshëm. "E rëndësishme, - tha z. Mziu, - është që Ndërmarrja e Ujësllës-Kanalizimeve të luajë rolin e vet, me shërbimin e duhur, me kosto më të vogël për të pasur një raport të drejtë mes ndërmarrjes dhe të ardhurave".

Duke folur për fazën e dytë të projektit, z. Mziu tha se sa më shpejt të fillojë, aq më tepër produkt do të japë ndërmarrja.

"Në pritje të fazës së dytë, ka një angazhim maksimal të ndërmarrjes dhe të Bashkisë. Sa më shpejt të fillojë faza e dytë, aq më tepër jep produkt ndërmarrja. Kështu që, shpresojmë që të fillojë faza e dytë, që të ndikojë në



integritetin e ndërmarrjes", - vijoi z. Mziu, i cili theksoi se Ujësllësi dhe Bashkia janë të lidhura organikisht dhe po punojnë për zhdukjen e informalitetit. Ai e informoi ekspertin Johannes Heeb për mundësinë që po sheh Bashkia për ndërtimin e një landfilli

për përpunimin e mbetjeve urbane.

Ndërmarrja e Ujësllësit tashmë është drejt finalizimit të projektit të ujësllësit në bashkëpunim me kompaninë zbatuese për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare problemit të furnizimit me ujë të qytetit.

Në këtë drejtim ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me kompaninë KfW, në kuadër të të cilit është bërë plotësimi dhe saktësimi i adresave për klientët; është hartuar raporti i monitorimit të performancës etj.

Falë aplikimeve të suksesshme të Bashkisë si dhe performancës e punës së jashtëzakonshme të Ndërmarrjes së Ujësllës-Kanalizimeve, është përfutur edhe faza e dytë e projektit për Kamzën, e përfshirë në "Programet III dhe IV të Infrastruktura Bashkiake", me donatorë KfW, SECO, Ambasada e Zvicrës dhe fonde të BE, me një vlerë të konsiderueshme. Faza e dytë do të bëjë të mundur ridimensionimin e një depoje tjetër uji me kapacitet 3000 metra kub.

Në total, rezervat e depove do të kenë një kapacitet ujëmbajtës 8300 metra kub. Në zonat që nuk janë prekur nga faza e parë

"Diskriminimi, urrejtja që ka treguar ndaj popullsisë së qytetit të pestë më të madh të Shqipërisë tregon se gjithë pushteti i tij për katër vite nuk ka qenë në ndihmë të qytetarëve, po kundër qytetarëve."

do të investohet duke konsideruar edhe një pjesë shumë të rëndësishme në sektorin e kanalizimeve të ujërave të ndotura. Në më shumë sesa 15 km kanale të hapura ujërash aktualisht, do të investohet duke marrë në konsideratë disa nga problematikat më të mprehta të konstatuara në vite.

Ndërkohë, nga Ndërmarrja e Ujësllës-Kanalizimeve është punuar në disa drejtime, siç është zgjerimi i zonave të mbulimit me ujë në Kamëz e Paskuqan; lufta ndaj informalitetit në çdo sektor; rritja e kapaciteteve dhe e burimeve njerëzore; rritja e performancës ekonomike të ndërmarrjes; vjelja e debive në vite; bashkëpunimi me sportelet e One Stop Shop-it në Kamëz, në njësitë administrative Bathore dhe Paskuqan.

Mbrojtja e fëmijëve/ Kryetari i Bashkisë, takim me përfaqësues të shoqatës "World Vision" dhe nxënës të shkollave të qytetit



Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, priti në një takim përfaqësues të shoqatës "World Vision" dhe nxënës të shkollave të qytetit. Takimi kishte në qendër të vëmendjes mbrojtjen e fëmijëve. Kryebashkiaku Xhelal Mziu tha se e mirëpriste këtë takim, pasi përveç shoqatës, kishte edhe nxënës, gjë që kishte munguar këto vite. Kërkesës së shoqatës "World Vision" për ngritjen e një strukture të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve, z. Mziu iu përgjigj se për momentin Bashkia nuk e ka të mundur një gjë të tillë, por theksoi se kjo njësi vendore ka disa struktura që e luajnë këtë rol, duke dhënë impaktin pozitiv e vet për këtë çështje. Struktura të tilla janë Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale; Drejtoria e Arsimit; ndërlidhësit me komunitetin,

fillojnë edhe adresohen problemet në mënyrën e duhur dhe gjejnë zgjidhje.

Ndërkaq, në Bashkinë Kamëz, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike mbulon me shërbime disa kategori personash, si:

1. Familjet në nevojë ekonomike;
2. Personat me aftësi të kufizuara;
3. Gratë e dhunuara;
4. Fëmijët e pambrojtur dhe me status jetimi;
5. Viktimat e trafikimit dhe të dhunës;
6. Familjet kujdestare të fëmijëve të pambrojtur etj.;
7. Qendrën polivalente të të moshuarve.

që veprojnë në Kamëz, Bathore dhe në Paskuqan. Gjithashtu, në Bashki ka edhe një specialist, pjesë e Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike, për gratë e dhunuara, fëmijët e dhunuar etj. Duke u shprehur se nuk shihet një vakum për sa i përket kësaj çështjeje, kreu i Bashkisë theksoi se ishte i gatshëm për bashkëpunime në të ardhmen. Kryebashkiaku Mziu shtoi se nëse ekziston bashkëpunimi midis Drejtorisë së Arsimit në Bashki dhe shkollave, problemet do të zgjidheshin, pasi nuk ka bashkëpunim mes shkollave e Zyrës Arsimore dhe Bashkisë. Sipas tij, nëse realizohet kjo,

Kryebashkiaku Xhelal Mziu në emisionin "Aktualitet" në TV "Shijak" nga gazetari Bejdo Malo



Kryebashkiaku Xhelal Mziu ishte i pranishëm në emisionin "Aktualitet" në TV "Shijak" nga gazetari Bejdo Malo. Në këtë emision kreu i Bashkisë Kamëz ka folur për qytetin dhe Bashkinë e Kamzës. Një qytet tashmë me 170 mijë banorë, i diskriminuar nga qeveria në këto katër vite. Z. Mziu ka folur se si e ka gjetur qytetin në fillim të mandatit të tij të parë, me vetëm 14 km rrugë, ndërsa tani ka më shumë sesa 160 km, të cilat do të shtohen vit pas viti. Pjesë e rëndësishme e bisedës ka qenë edhe projekti madhor i ujësllës-kanalizimeve, faza e parë e të cilit ka përfunduar dhe pritet faza e dytë. Ndërkaq, është folur edhe për arsimin, fushë në të cilën ka pasur një progres të jashtëzakonshëm, duke u ndërtuar 18 objekte shkollore, falë bashkëpunimit të Bashkisë me qeverinë Berisha dhe organizma të huaj. Në emision është komentuar edhe situata politike, veçanërisht në Kamëz, qytet i cili është quajtur si kështjellë e Partisë Demokratike.



Investimi drejt përfundimit, kryebashkiaku Xhelal Mziu inspekton punimet në rrugën “Demokracia”

Diskriminimit të qeverisë Bashkia Kamëz iu përgjigj me punë, shërbime dhe investime për qytetarët, të cilat janë financuar vetëm nga buxheti i Bashkisë

Ndryshimi në infrastrukturën e Paskuqanit vihet re nga të gjithë ata që kanë kaluar në këtë zonë, qoftë edhe për një herë të vetme. Që nga viti i parë i reformës territoriale, kur Paskuqani iu bashkua Kamzës e deri tani, dhjetëra investime të financuara vetëm nga buxheti i Bashkisë Kamëz janë realizuar e po realizohen. Vetëm për vitin 2017, janë 30 projekte të cilat kanë nisur të zbatohen në terren. Rruga “Demokracia”, e cila është edhe rruga kryesore e Paskuqanit, ishte investimi kryesor në këtë zonë, i ideuar



që në vitin 2015 dhe që ishte ndër premtimet kryesore të kryebashkiakut Xhelal Mziu për mandatin e tretë. Ndërsa jemi në vitin e dytë të këtij mandati, punimet në këtë segment prej 7 km janë drejt përfundimit. Të gjithëve u kujtohet gjendja e kësaj rruge si ka qenë dhe si po transformohet çdo ditë falë investimit të Bashkisë Kamëz dhe kujdesit të veçantë të kryebashkiakut Xhelal Mziu. Ndonëse iu kërkua



qeverisë qysh në vitin 2015 të financonte këtë projekt, nuk pati përgjigje pozitive nga pushteti qendror jo vetëm për këtë rrugë, por as për dhjetëra e dhjetëra projekte të tjera me të cilat aplikoi Bashkia Kamëz pranë ministrive përkatëse. Këtij diskriminimi të pashoq Bashkia Kamëz iu përgjigj me punë, shërbime dhe investime për qytetarët, të cilat janë financuar vetëm nga buxheti i saj.

Emër i ri, investim i ri i Bashkisë Kamëz, ndërtohet rruga “Republika e Re”



Ndërtimi i rrugës “Republika e Re” është një tjetër investim i Bashkisë Kamëz që po realizohet këto ditë. Për të parë nisjen e punimeve në këtë segment rrugor ishte i pranishëm kryebashkiaku Xhelal Mziu, i cili ka theksuar se vetëm për këtë vit Bashkia po realizon 60 projekte në infrastrukturë. Rruga “Republika e Re” ndodhet në lagjen Kamëz nr. 3. Ky segment rrugor është një arterie kryesore, e cila shërben për të lidhur një pjesë të rëndësishme të lagjes nr. 3 Kamëz me Valiasin, pasi lidh rrugën “Abdi Bej Toptani” me rrugën “Kongresi i Manastirit”. Segmenti rrugor ku po investohet është i gjatë 1040 ml, me gjerësi rruge 8 m. Gjerësia ekzistuese varion nga 3 deri në 5 m, e cila është rrugë me taban për një gjerësi prej 3 m në pjesën më të madhe të saj dhe nga ana lindore e këtij segmenti rrugor janë ndërtuar kanalizimet e ujërave të ndotura me tubacione Ø 400, Ø 600 dhe puseta çdo 50 m.

Vijon puna për ndërtimin e rrugës “Liria” në Frutikulturë

Vijon puna për ndërtimin e rrugës “Liria” në Frutikulturë. Për të inspektuar punimet ishte i pranishëm kryebashkiaku Xhelal Mziu, duke qenë se ky është një nga investimet më të rëndësishme në këtë lagje. Kjo rrugë kufizohet me rrugën “Skënderbeu” dhe me bulevardin



“Donald J. Trump”, duke qenë kështu pjesë e një rrjeti të rëndësishëm rrugor që bën lidhjen e disa lagjeve në Kamëz. Segmenti rrugor ku po investohet është i gjatë më shumë se 1 km (1119 ml), gjerësi 10 ml, kunetë dhe trotuare 2.5 ml në të dyja anët e rrugës. Në fakt, në çdo lagje të qytetit ka investime të financuara nga buxheti i Bashkisë, ndërkohë që nga qeveria asnjë projekt nuk është financuar në këto katër vite. Megjithatë, gjendja e infrastrukturës urbane në Kamëz, por tashmë edhe në Paskuqan, po njih progres vit pas viti. Falë punës dhe angazhimit maksimal të Bashkisë, infrastruktura urbane e qytetit është e pakrahueshme me të kaluarën, po ashtu edhe me njësi të tjera vendore.

Ndërtimi i Rrugës së Zanave dhe i rrugës “Torino”, një standard më i lartë për infrastrukturën e lagjes Bathore 1



Ndërtimi i Rrugës së Zanave dhe i rrugës “Torino” do të jetë një standard më i lartë për infrastrukturën urbane të lagjes Bathore 1. Ky investim i vetëfinancuar nga Bashkia Kamëz do t’u vijë në ndihmë mijëra banorëve. Kryebashkiaku Xhelal Mziu, i cili ka inspektuar punimet në këto rrugë, ka bërë me dije se në gjashtë muaj janë realizuar nga Bashkia ose janë drejt përfundimit 60 projekte infrastrukturore. Rruga “Torino” me gjatësi 175 m, si dhe segmenti ku po investohet te Rruga e Zanave, me gjatësi 350, ndodhen në lagjen Bathore 1 të Bashkisë Kamëz. Këto segmente rrugore shërbejnë për të lidhur një pjesë të rëndësishme të lagjes Bathore 1 me Bulevardin Blu. Ato më parë kanë qenë të pashtuara me asfalt dhe gati në të gjithë gjatësinë e tyre kanë qenë shtruar me zhavorr nga vetë banorët. Me përfundimin e investimit të Bashkisë, këto rrugë, ashtu si edhe qindra kilometra rrugë të tjera në Kamëz e Paskuqan, do të kenë standarde bashkëkohore. Përveç krijimit të lehtësirave për kalimin e këmbësorëve dhe të automjeteve, investime të tilla ndikojnë edhe në zhvillimin e biznesit, gjë e cila ndikon pastaj në punësim dhe në rritjen e të ardhurave të vetë banorëve. Duke u nisur edhe nga ky qëllim, Bashkia ka pasur përparësi të sajën krijimin e një infrastrukture të favorshme, si për qytetarët, familjet e tyre, por edhe për kompanitë private. Për këtë arsye dhe për shkak të një pakete fiskale të favorshme shumë kompani kanë sjellë aktivitetet e tyre në territorin e Bashkisë Kamëz.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu inspekton punimet në rrugën “Coca-Cola” (vazhdim) në Laknas me gjatësi 1790 m

Kryebashkiaku Xhelal Mziu inspektoi punimet edhe në rrugën “Coca-Cola” (vazhdim) në Laknas me gjatësi 1790 ml. Ndërtimi i vazhdimit të rrugës “Coca-Cola” në Laknas me gjatësi 1790 m është një nga investimet e rëndësishme të Bashkisë Kamëz. Përveç gjatësisë së saj, që shkon deri në 2 km dhe me gjerësi 7 metra, realizimi i këtij projekti sjell një impakt të jashtëzakonshëm social, si për banorët e zonës, ashtu edhe për ata që zgjedhin të kalojnë në këtë segment rrugor. Si banorët, ashtu edhe përfaqësuesit e bizneseve që ndodhen në këtë rrugë shprehen të kënaqur për realizimin e këtij



investimi, duke falënderuar me këtë rast Bashkinë Kamëz dhe kryebashkiakun Xhelal Mziu. Ky investim shtrihet në një zonë problematike në kohën e reshjeve, të cilat shkaktojnë përmytje. Për këtë qëllim, Bashkia Kamëz ka ndërhyrë me anë të këtij investimi për të krijuar kushte më të mira jetese për qytetarët dhe për zhvillimin e bizneseve. Shqetësimet dhe kërkesave të komunitetit Bashkia Kamëz u është përgjigjur me, me punë, me investime publike dhe shërbime cilësore.



Ndryshimi që vërehet nga puna e Bashkisë, blloku Babrru-Qendër merr dita-ditës pamje tjetër

60 investime në 6 muaj në Kamëz e Paskuqan, falë angazhimit maksimal të Bashkisë



Dita-ditës merr pamje tjetër blloku i pallateve në Babrru-Qendër. Kjo, falë punës së Bashkisë Kamëz, e cila ka investuar për rivitalizimin e këtij blloku ndërtimesh.

Ky projekt është ndër investimet e shumta të Bashkisë Kamëz që po realizohet tërësisht me anë të buxhetit të kësaj njësie vendore, në një kohë kur nga qeveria shqiptare nuk është dhënë asnjë qindarkë për këtë qytet.

Rikualifikimi urban i bllokut të ndërtimeve në Babrru-Qendër është një projekt i cili kushton rreth 1 miliard e 400 milion lekë dhe që do të ketë ndikim të gjerë social në komunitetin e banorëve të zonës.

Ky projekt përfshin në vetvete të gjithë infrastrukturën e nevojshme, duke filluar nga rrugët, sheshet, lulishtet, ndriçimi etj. Krahas rehabilitimit të rrugës kryesore "Demokracia", rikualifikimi i këtij blloku përbën një tjetër ndërhyrje të rëndësishme të Bashkisë në zonën e Paskuqanit.

Punimet për rikualifikimin urban të këtij blloku kanë avancuar me ritme të shpejta. rryebashkiaku Xhelal Mziu, që ka inspektuar disa herë këto punime, shprehet i kënaqur që edhe një prej premtimeve dhe sfidave të tij po realizohet. Për këtë janë dëshmitarë banorët e zonës dhe qytetarët që kalojnë aty.

Rikualifikimi urban i bllokut të ndërtimeve në Babrru-Qendër është ndër investimet e shumta të Bashkisë Kamëz në Njësinë Administrative të Paskuqanit.

Në dallim nga qeveria, e cila për katër vjet radhazi ka diskriminuar Kamzën dhe Paskuqanin, duke mos akorduar asnjë fond për dhjetëra projekte emergjente, për të cilat qyteti ka nevojë, Bashkia, duke u mbështetur në të ardhurat e veta, po investon në projekte madhore, siç është rruga 7 km "Demokracia" në Paskuqan, rikualifikimi urban i bllokut të ndërtimeve në Babrru-Qendër, si dhe dhjetëra projekte të tjera.

Nis ndërtimi i KUN dhe rrugës "Arben Broci" në Paskuqan



Ka përfunduar procedura e prokurimit edhe për ndërtimin e rrugës "Arben Broci" në lagjen Paskuqan 2 bashkë me kanalizimet e ujërave të ndotura. Ky investim financohet tërësisht nga të ardhurat e Bashkisë. Me këtë ritëm të investimeve, Bashkia Kamëz vijon realizimin e projekteve të rëndësishme në infrastrukturën urbane të qytetit.

Ky investim ka rëndësi të veçantë, jo thjesht për faktin se ka një gjatësi të konsiderueshme prej 685 ml, por sepse do të ketë infrastrukturë të plotësuar rrugore dhe infrastrukturë nëntokësore.

Gjithashtu, gjerësia e saj do të jetë 8 ml, me kuletë anash, si dhe me trotua 2.5 ml në të dyja anët e saj. Përveç përmirësimit të infrastrukturës, realizimi i këtij projekti do të ndikojë edhe në zhvillimin e bizneseve ekzistuese, si dhe në çeljen e aktiviteteve të reja të sipërmarrjes së lirë.

Prej kësaj do të përfitojnë qytetarët e kësaj zone, duke pasur më shumë mundësi për punësim dhe për prirjen e nivelit të jetesës.

Ndërtimi i rrugës "Ymer Haxhi Prizreni" në Babrru-Shpat, inspekton punimet kryebashkiaku Xhelal Mziu



Pas përfundimit të procedurave të prokurimit, kanë nisur punimet për ndërtimin e rrugës "Ymer Haxhi Prizreni" në Babrru-Shpat. Për të inspektuar punimet ka qenë kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu.

Ai pa nga afër punën që po kryhet në këtë segment rrugor, si dhe kërkoi angazhim maksimal për përfundimin në kohë dhe në cilësi të punimeve.

Gjatësia e rrugës "Ymer Haxhi Prizreni" është rreth 1 km. Në 1050 ml të gjatësisë së kësaj rruge, parametrat do të jenë bashkëkohorë, me qëllimin për të ofruar një infrastrukturë të një standardi të lartë për banorët e kësaj zone.

Kjo rrugë ndodhet në lagjen Babrru-Shpat të Njësisë Administrative të Paskuqanit. Ndërtimi i rrugës "Ymer Haxhi Prizreni", që financohet nga buxheti i Bashkisë, sjell një ndikim të madh social te qytetarët, pasi përmirëson ndjeshëm kushtet në të cilat ndodhet kjo rrugë, duke sjellë kështu lehtësinë e lëvizjes, si të këmbësorëve ashtu edhe të automjeteve.

Rruga "Halim Xhelo" në lagjen Paskuqan 1, e gatshme për të filluar punimet



Rruga "Halim Xhelo" në lagjen Paskuqan 1 është e gatshme për të filluar punimet.

Kjo, pas përfundimit të procedurës së prokurimit dhe lidhjes së kontratës me subjektin fitues.

Rruga "Halim Xhelo" do të shërbejë si një arterie lidhëse e rrugës kryesore "Demokracia" me rrugën "Besim Çera", duke qenë kështu një investim mjaft i rëndësishëm për komunitetin e zonës.

Kjo rrugë bën lidhjen e një zone, që është shumë e populluar, me lagjet e tjera të Paskuqanit, por edhe të zonave të tjera.

Kjo rrugë ka një gjatësi prej 812 ml dhe me gjerësi 4 ml. Ndërtimi i këtij segmenti rrugor ka rëndësi të madhe sociale dhe ekonomike, pasi ndikon në lehtësimin e lëvizjes së këmbësorëve dhe të automjeteve.

Gjithashtu, ky investim do t'i japë një impuls pozitiv edhe zhvillimit të bizneseve, të cilat do të bëjnë të mundur hapjen e vendeve të reja të punës.

Përfundon procedura e prokurimit për rrugën "Veli Dede" në lagjen Fushë-Kërçik të Paskuqanit



Ka përfunduar procedura e prokurimit për ndërtimin e rrugës "Veli Dede" në lagjen Fushë-Kërçik të Paskuqanit, kështu që kanë nisur punimet për realizimin e këtij projekti. Ndërtimi i kanalizimeve dhe i rrugës "Veli Dede" në lagjen Fushë-Kërçik të Paskuqanit është vijim i projekteve që do të realizohen nga Bashkia Kamëz gjatë vitit 2017. Gjatësia e segmentit ku do të realizohet investimi është 380 ml dhe gjerësia 5.5 ml. Rruga "Veli Dede" është një arterie lidhëse me Rrugën e Kërçikëve, e cila lidhet me rrugën kryesore "Demokracia". Kjo rrugë aktualisht është funksionale, por në zgjidhjen planimetrike është pasur parasysh që të bëhet asfaltimi i saj dhe të krijohet infrastruktura nëntokësore, duke ndërtuar sistemin e kanalizimeve.



Transporti publik, Bashkia Kamëz shton një tjetër linjë të re qytetëse

Një tjetër arritje në përmbushje të synimeve të Drejtorisë së Transportit, Lejeve dhe IT-së në Bashkinë Kamëz është fillimi i shërbimeve të rregullta të linjës qytetëse në zonën e Laknasit, në lagjen "Lura". Kjo linjë përshkon itinerarin Qendër-Kamëz - rruga "Kozare" - rruga "Lunxhëria" - rruga "Lura" - rruga "Coca-Cola" dhe kthim në Qendër-Kamëz. Kjo do të bëjë të mundur rritjen e shërbimit të transportit urban dhe transportit publik në qytetin e Kamzës, duke synuar një qasje të integruar të zhvillimit, përmirësimit të jetës së qytetarëve për një transport publik të shpejtë dhe të besueshëm.

Qytetarët shprehen shumë të lumtur me shtimin e linjave të reja në Kamëz. Para disa javësh qytetit iu shtuan edhe tri linja të tjera të reja. Me këtë linjë shkon në katër numri i linjave të reja në Bashkinë Kamëz, kjo me qëllimin për të qenë sa më pranë qytetarëve me shërbimin e transportit. Tashmë qytetarët e Kamzës e kanë shumë të lehtë për të shkuar nga një zonë në një zonë tjetër duke përdorur transportin urban. Më përpara ishte shumë e vështirë, pasi duhej të përdorje mjedin privat për të shkuar nga një lagje në tjetrën, pasi nuk kishte linja transporti urban.



Drejtorja e Transportit, Lejeve, Licencave dhe IT-së ka si mision të saj menaxhimin e rrjetit rrugor dhe transportit publik në qytetin e Kamzës, duke synuar një përqasje të integruar të zhvillimit ekonomik, përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së ambientit. Gjithashtu, pjesë e misionit të kësaj drejtorie është edhe zhvillimi i një rrjeti rrugor dhe një transporti publik të shpeshtë, të shpejtë, të besueshëm

dhe të rehatshëm.

Ndërkaq, si synim për të ardhmen, për sa i përket rregullimit të transportit, Drejtorja e Transportit po ndërmer disa masa dhe hapa të rëndësishëm në punën e saj, si:

Studimi i sistemit të sinjalistikës rrugore për të gjithë sistemin rrugor të Bashkisë Kamëz.

Vënia në funksion e studimit dhe riorganizimit të transportit publik urban për

Linja e re ka itinerarin Qendër-Kamëz - rruga "Kozare" - rruga "Lunxhëria" - rruga "Lura" - rruga "Coca-Cola" dhe kthim në Qendër-Kamëz.

Bashkinë Kamëz

Lufta ndaj informalitetit në transportin rrugor.

Ndjekja dhe ulja e debitorëve në maksimumin e mundshëm.

Lirimi i hapësirave publike të parkingjeve dhe vënia në dispozicion e tyre për komunitetin.

Studimi për organizimin e stacionimit të shërbimit taksi.

Studimi për krijimin e mundësive për ndërtimin e parkingjeve publike.

Drejtorja e Shërbimeve Publike monitoron tabelat e emërtimit rrugor për zëvendësimin e atyre të dëmtuara



Drejtorja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Kamëz ka ngritur grupin e punës për konstatimin e gjendjes së tabelave të emërtimit të rrugëve në gjithë territorin e Bashkisë. Grupi i punës, i përbërë me specialistë të drejtorisë, ka si synim mbajtjen e aktkonstatimeve për çdo tabelë të emërtimit rrugor, e cila është dëmtuar ose hequr.

Nisur nga vëzhgimet e drejtpërdrejta në terren është konstatuar që disa prej tabelave të sistemit të adresave janë dëmtuar, gjë e cila vështirëson orientimin e qytetarëve apo institucioneve për marrjen dhe dhënien e shërbimeve të ndryshme. Po punohet shumë nga specialistët e Drejtorisë së Shërbimeve që çdo tabelë e dëmtuar apo e hequr të zëvendësohet menjëherë.

Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit, shërbim në kohë dhe me cilësi, 50 kontejnerë të rinj në rrugët kryesore

Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit në Bashkinë Kamëz ka rritur ritmin e punëve dhe cilësinë e tyre. Strukturat e kësaj ndërmarrjeje janë organizuar për të përmbushur me seriozitet të gjitha detyrat e kësaj periudhe, në të cilën rritet sasia e mbeturinave me natyrë organike dhe joorganike, për të përballuar rritjen e sasive të mbeturinave si nga familjet ashtu dhe nga bizneset, pasi rritet edhe konsumi, edhe veprimtaria e prodhimit nga ana e këtyre të fundit.

Për të përballuar situatat e fillimit të rritjes së sasisë së mbeturinave me natyrë të ndryshme këto ditë janë shpërndarë rreth 50 kontejnerë të rinj përgjatë segmenteve kryesore të Bashkisë Kamëz. Kontejnerët janë pjesë e përfitimit të projektit IPA Adriatik si vlerësim i seriozitetit që Bashkia Kamëz ka paraqitur dhe vazhdon të paraqesë përpara partnerëve ndërkombëtarë si përfituese e vazhdueshme e projekteve të financuara nga institucionet më prestigjioze ndërkombëtare.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu në këto ditë i ka kërkuar të gjithë administratës së Bashkisë Kamëz që të përqendrohet vëmendja kryesisht tek investimet dhe shërbimet ndaj qytetarëve.

Kjo shtrirje e shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz në drejtim të pastrim-gjelbërimit do të sjellë për mbarë qytetarët e bashkisë Kamëz një ambient më cilësor jete për ta.

Shërbimet nuk janë vetëm grumbullimi dhe transportimi në venddepozitim i mbeturinave me natyrë organike dhe joorganike, por edhe pastrimi dhe ujitja e pemëve dekorative të kultivuara në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz.

Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve Kamëz, e gatshme për të qenë afër qytetarëve me shërbimet e saj



Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve në Bashkinë Kamëz është gjithnjë në gatishmëri për të qenë afër qytetarëve me shërbimet që ofron.

Duke pasur në qendër të vëmendjes qytetarin dhe rritjen e cilësisë së shërbimit, kjo ndërmarrje po shfrytëzon çdo moment të ditës për të mirëmbajtur rrjetin e ujësjellësit, por edhe atë të kanalizimeve. Intensiteti i lartë i punës po karakterizon këtë periudhë, duke qenë se qyteti ka më shumë nevojë.

Nga punonjësit e kësaj ndërmarrjeje po punohet në çdo segment rrugor kryesor të qytetit, ashtu edhe në brendësi të lagjeve për të riparuar çdo defekt të mundshëm, që ndikon në furnizimin e banorëve me ujë të pijshëm.

Kjo është edhe një prej detyrave funksionale dhe objektive të strukturave të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, që po i përmbush hap pas hapi.



Kryebashkiaku Xhelal Mziu përshëndet në ditën finale të festivalit të kopshteve të qytetit “Cicërimat e Kamzës”



Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, ishte i pranishëm në ditën finale të festivalit të kopshteve të qytetit “Cicërimat e Kamzës”. Ky edicion i katërt i festivalit të kopshteve u zhvillua për pesë ditë, nga data 5 deri më 9 qershor. Duke iu drejtuar fëmijëve të kopshteve, kryebashkiaku Mziu tha se për pesë ditë me radhë ata e zbukuruan Pallatin e Kulturës dhe qytetin. “Ju falënderoj për zbukurimin e Pallatit të Kulturës dhe të qytetit tonë për pesë ditë me radhë. Ishte edicioni i katërt dhe jam i sigurt që vitin tjetër do të jetë



shumë herë më i kompletuar”, - u shpreh z. Mziu, i cili ka përgëzuar të gjithë fëmijët për pjesëmarrjen në këtë festival. “Dua t’i përgëzoj për zotërisht të gjithë këta fëmijë mjaft të mirë, të cilët ishin në skenë në këto pesë ditë. Dua të falënderoj edukatorët e këtyre fëmijëve, njëherazi edhe prindërit, të cilët kanë këta fëmijë kaq të mrekullueshëm dhe që janë bërë pjesë e këtij festivali”, - ka vijuar kreu i Bashkisë, duke i uruar në fund të fjalës së tij që t’i kalojnë sa më bukur pushimet e verës.

“Ju falënderoj për zbukurimin e Pallatit të Kulturës dhe të qytetit tonë për pesë ditë me radhë. Ishte edicioni i katërt dhe jam i sigurt që vitin tjetër do të jetë shumë herë më i kompletuar”, - u shpreh z. Mziu.



Në Pallatin e Kulturës Kamëz, koncert recital i nxënëses dhe këngëtares së re Eglantina Babqori



Në skenën e Pallatit të Kulturës Kamëz, në vijim të veprimtarive kulturore e artistike, u realizua me sukses koncerti recital i Eglantina Babqorit, titulluar “Tinguj rinorë”. Eglantina Babqori, një nxënëse e talentuar e shkollës së mesme, është një e re mjaft e talentuar, vetëm 16 vjeçe. Ajo interpretoi me mjaft profesionalizëm dhe me nivel të lartë artistik 10 këngë, një pjesë prej të cilave në gjuhën angleze. Koncerti u përcoll nga duartrokitje të vazhdueshme të pjesëmarrësve. Koncertin e saj e përshëndeti me interpretimin artistik Maria Balla si dhe grupi aerobik i shkollës “Kolë Jakova”, i cili dha mesazhe të forta kundër dhunës ndaj grave. Eglantina përshëndeti Bashkinë Kamëz, kryetarin e saj, stafin e Pallatit të Kulturës për mundësinë e krijuar.

Intervistë e Eglantina Babqorit për portalin “Politiko.al”/ Eglanta 16 vjeçe, koncert me një kitarë

Talentet nuk sillen gjithmonë rreth zonës së Bllokut, as nuk janë gjithmonë në qendër të vëmendjes së mediave. Ka midis tyre që jetojnë në zona të vogla, ku mundësitë janë krejtësisht të kufizuara. Shumë pranë vijës së verdhë të Tiranës, aty sa

kalon kufirin, në Kamëz ka shumë të rinj të talentuar. E talentuar është edhe Eglanta.

Me zërin e saj ajo ka mundur të tërheqë vëmendjen mijëra të rinjve që e ndjekin në Instagram, midis tyre edhe këngëtarë të njohur. Vetëm 16 vjeçe. Zëri i saj është kaq i bukur sa arrin të përçojë shumë emocione edhe përmes disa videove krejt amatore. Nuk ka marrë mësim nga lektorë të njohur të muzikës, sepse nuk ka bërë shkollë muzike. Këtë vit ka nisur një kurs. Në aktivitetet e shkollës apo siç ajo pëlqen t’i quajë në koncertet e shkollës, ka mundur të tregojë talentin e saj, i cili është evidentuar menjëherë nga bashkëmoshatarët, të cilët janë

kthyer në fansat e saj më të zjarrtë. Bashkë me një kitarë Eglanta ka çuditur një Pallat Kulturë.

Vetëm pak ditë më parë ajo ka organizuar një aktivitet në ambientet e Pallatit të Kulturës së Kamzës. Koncerti i saj i parë! Në një intervistë (impresionon) të shkurtër për “Politiko.al” Eglanta tregon se mbështetja më e madhe për të është familja. “Babi më ka blerë mikrofonin e parë”, - tregon Eglanta.

Eglanta, në çfarë hapësirash këndon? Në profilin tënd në Instagram duket se je ftuar edhe në organizime të mbrëmjeve letrare.

Unë këndoj në ato organizime që më ftojnë. Nuk jam e njohur ende dhe nuk kam marrë ftesa për organizime të mëdha. Shkoj me kënaqësi atje ku më ftojnë. Zakonisht jam në Qendrën Kulturore të Kamzës, veçanërisht në aktivitetet e moshatarëve të mi.

Ke bërë shkollë për kanto?

Jo, nuk kam bërë shkollë. Këtë vit jam regjistruar në një kurs.



Këngët e tua i shoqëron edhe me kitarë. Kush ta ka mësuar kitarën?

Kitarën e kam mësuar në kurs. Nuk kam bërë shumë, sepse prindërit më para më patën mësuar çiftelinë. Pastaj e pata shumë të thjeshtë me kitarën.

Cilat janë pritshmëritë e tua për të ardhmen?

Dua të bëhem këngëtare profesioniste. Të njihem për talentin tim. Jo thjesht më pëlqen, por është ëndrra ime më e madhe.

Ke menduar të angazhohesh në këto show-et e dedikuara talenteve të reja?

Po, patjetër. Dua ta nis kështu. Njerëzit të më njohin për zërin, të më vlerësojnë për zërin dhe ta duan atë.



Kryebashkiaku Xhelal Mziu përgëzon ekipin e futbollit për shpalljen kampion i Kategorisë së Parë

Në një takim me ekipet e sporteve të ndryshme të qytetit, kryetari i Bashkisë Kamzë, z. Xhelal Mziu, përgëzoi ekipin e futbollit, që u shpall kampion i Kategorisë së Parë dhe u ngjit në Superligë.

“Dua të përsëhendes në mënyrë të përzemërt ekipin e futbollit që u shpall kampion i grupit, kampion i Kategorisë së Parë dhe ju uroj suksese për të qenë konkurrues edhe në Superligë, nëse jo kampion, për të qenë në vendet e para”, - u shpreh z. Mziu, duke shtuar se e rëndësishme është që Kamza ka një ekip solid dhe të angazhuar për të mos qenë provizorë në Superligë.

Në këtë takim, kreu i Bashkisë shprehu falënderimet e tij edhe për ekipet e basketbollit, meshkuj dhe femra. Ai theksoi se tashmë basketbolli është kthyer në një sport familjar, një sport mbarëpopullor në Kamzë.

Sipas kryebashkiakut Mziu, edhe karateja e ka rritur ndjeshëm performancën, duke arritur rezultate pozitive në çdo veprimtari. Gjatë fjalës së tij, z. Mziu tha se qyteti ka edhe ekipet e mundjes, të boksit etj., të cilat nuk janë më një luks, por që duhet të mbështeten edhe nga Bashkia, edhe nga qeveria, sepse qyteti ka nevojë edhe për to.

“Ne gëzohemi kur ekipet tona, sportistët e tyre, marrin medalje, sepse bëjnë krenar qytetin, por edhe Shqipërinë, kur ato marrin pjesë në



veprimtari ndërkombëtare. Ajo që unë garantoj, është se Bashkia është e angazhuar maksimalisht për të bërë gjithçka për promovimin e çdo sporti, të çdo disipline sportive për të arritur majat më të larta”, - është shprehur kryetari i Bashkisë, z. Xhelal Mziu.

Në ndeshjen finale të Kategorisë së Parë, grupi A, Kamza barazoi me Besëlidhjen, duke siguruar ngjitjen në elitën e futbollit shqiptar. Festa e sportdashësve pati shpërthyer në shkallët e stadiumit dhe në rrugët e qytetit, ku pas 5 vitesh ekipi i tyre i zemrës u rikthye në Superiore. Kamza u shpall edhe kampion e Kategorisë së Parë, pasi mposhti Lushnjën pas gjuajtjeve të 11 metërshave, 5-4. Ishte ky premtimi i kryebashkiakut

Xhelal Mziu i bërë realitet pikërisht pas një pune shumë të madhe të futbollistëve dhe stafit të ekipit të Kamzës – ngjitja në Superiore dhe shpallja ekip kampion i Kategorisë së Parë.

Bashkia e Kamzës i ka dhënë mbështetje maksimale ekipit dhe kryebashkiaku Xhelal Mziu pati premtuar në merkaton e verës rikthimin e Kamzës në Superligë. Premtimi që bërë nga kryebashkiaku në zyrën e tij teksa qenë prezantuar tri blerje të reja të Kamzës, me synimin e vetëm ngjitjen në elitën e skuadrave më të mira të futbollit shqiptar. Kamza ka zhvilluar një kampionat bindës, duke kryesuar kampionatin që nga ndeshja e parë.

BASHKIA KAMZË



Informacione

- Sipërfaqe 40.357 km²
- Qyteti i gjashtë, 150.000 banorë
- Atraktive për biznesin, mbi 3000
- Mbi 18,000 të punësuar privat
- Mosha mesatare 27 vjeç
- Sistem i plotë adresash
- Rrugë të asfaltuara mbi 200 km
- One Stop Shop modern
- Pallati i Kulturës, Stadiumi etj...

Kontakte

www.kamza.gov.al

[f bashkiakamez](#)

[f xhelalmziu](#)

[xhelalmziu](#)

Partneritete

- Bashkimi Europian
- Banka Botërore
- USAID
- KfW
- GIZ
- Macerata, Itali
- Jena, Gjermani
- Galway, Irlandë

Adresa: Bulevardi “BLU” Nr 492 Kamez, tel: +355 47 200 177, e-mail: bashkiakamez@gmail.com, www.kamza.gov.al

Gazeta KAMZA: Drejtor Artan Dervishi; kryeredaktor Behar Hoxhaj, gazetarë: Edmond Duraku, Mina Hysa